



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 63

Tiranë – E enjte, 2 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 24.4.2019	Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat “Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës” 4833
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 234, datë 19.4.2019	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar..... 4833
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 264, datë 19.4.2019	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Ulzës dhe Shkopetit..... 4848
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 265, datë 19.4.2019	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe Prespës..... 4848
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 244, datë 19.4.2019	Për delegim kompetencash..... 4849

**VENDIM****Nr. 258, datë 24.4.2019****PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT “PËR OFRIMIN E
SHËRBIMIT LABORATORIK TË
SPITALEVE UNIVERSITARE,
RAJONALE DHE ATYRE BASHKIAKE
TË SARANDËS DHE LUSHNJËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat “Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR**Nr. 234, datë 19.4.2019****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
DHE TË ORGANIKËS SË ZYRAVE
VENDORE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Zyrave Vendore të Arsimit, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, të jetë sipas skemës 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Fier, të jetë sipas skemës 3, 3/1 dhe 3/2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë, të jetë sipas skemës 4, 4/1 dhe 4/2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Organika e Zyrave Vendore të Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë, të jetë sipas skemës 5, 5/1 dhe 5/2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Numri i punonjësve të Zyrave Vendore të Arsimit të jetë gjithsej 428 vetë.


Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Besa Shahini



SKEMA 1

STRUKTURA E ZYRËS VENDORE ARSIMORE





SKEMA 2

**ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE DURRËS
ZYRAT VENDORE ARSIMORE: BULQIZË, MAT, KLOS, SHIJAK, KAVAJË, VORË, RROGOZHINË**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(2)
SPECIALIST JURIST	IV-c	1
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	1
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	1
SPECIALIST	IV-c	2

PUNONJËS GJITHSEJ 6

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT E VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 42 VETA.



SKEMA 2/1

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE ARSIMORE TË DREJTORISË RAJONALE DURRËS

ZYRAT VENDORE ARSIMORE: DIBËR, KRUJË, KAMZË

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>1</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT		<u>(6)</u>
PROFESIONAL		
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>5</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 10**NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 30 VETA.**



SKEMA 2/2

ORGANIKA E ZYRËS VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE Durrës

ZYRA VENDORE ARSIMORE Durrës

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>2</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		(8)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>7</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 13

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË ZYRËN VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 13 VETA.



ORGANIKA E ZYRËS VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE DURRËS

ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(8)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>2</u>
SPECIALIST INXHINIER	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>3</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		(16)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>15</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 25

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË ZYRËN VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 25 VETA.



SKEMA 3

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTROISË RAJONALE ARSIMORE FIER

ZYRAT VENDORE ARSIMORE: PATOS, ROSKOVEC, DIVJAKË, MALLAKASTËR, SELENICË, DELVINË-FINIQ

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(2)
SPECIALIST JURIST	IV-c	1
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	1
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT		(3)
PROFESIONAL		
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	1
SPECIALIST	IV-c	2

PUNONJËS GJITHSEJ **6**

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT E VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 36 VETA.



SKEMA 3/1

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE FIER

ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT: TEPELENË-MEMALIAJ, PËRMET-KËLCYRË, SARANDË-KONISPOL, LUSHNJË, GJIROKASTËR-LIBOHOVË-DROPULL

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>1</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		<u>(6)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>5</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 10

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 50 VETA.



SKEMA 3/2

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE FIER

ZYRAT VENDORE ARSIMORE: VLORE-HIMARË, FIER

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(4)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>2</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT		<u>(9)</u>
PROFESIONAL		
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>8</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 14**NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 28 VETA.**



SKEMA 4

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE KORÇË

ZYRAT VENDORE ARSIMORE: URA VAJGURORE, KUÇOVË, CËRRIK, BELSH, PEQIN, GRAMSH, LIBRAZHD, PËRRENJAS, MALIQ, KOLONJË, DEVOLL

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(2)
SPECIALIST JURIST	IV-c	1
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	1
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT		(3)
PROFESIONAL		
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	1
SPECIALIST	IV-c	2

PUNONJËS GJITHSEJ 6

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT E VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 66 VETA.



SKEMA 4/1

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE KORÇË

ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT: SKRAPAR-POLIÇAN, BERAT, KORÇË-PUSTEC, POGRADEÇ

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>1</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		<u>(6)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>5</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 10

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 40 VETA.



SKEMA 4/2

ORGANIKA E ZYRËS VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE KORÇË

ZYRA VENDORE ARSIMORE: ELBASAN

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(4)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>2</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT		<u>(9)</u>
PROFESIONAL		
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>8</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 14**NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË ZYRËN VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 14 VETA.**



SKEMA 5

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE LEZHË

ZYRAT VENDORE ARSIMORE: HAS, TROPOJË, MIRDITË, MALËSI E MADHE, VAU-DEJËS

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(2)
SPECIALIST JURIST	IV-c	1
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	1
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	1
SPECIALIST	IV-c	2

PUNONJËS GJITHSEJ 6**NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 30 VETA.**



SKEMA 5/1

ORGANIKA E ZYRAVE VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE LEZHË

ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT: PUKË – FUSHË-ARRËZ, KUKËS, LEZHË, KURBIN

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>1</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		<u>(6)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>5</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 10

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË TË GJITHA ZYRAT VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 40 VETA.



SKEMA 5/2

ORGANIKA E ZYRËS VENDORE TË DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE LEZHË

ZYRA VENDORE ARSIMORE: SHKODËR

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1. DREJTOR ZYRE	IV-a	<u>1</u>
1.1 SEKTORI I SHËRBIMEVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST JURIST	IV-c	<u>1</u>
SPECIALIST I FINANCËS	IV-c	<u>2</u>
1.2 SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL		(8)
PËRGJEGJËS SEKTORI	IV-b	<u>1</u>
SPECIALIST	IV-c	<u>7</u>

PUNONJËS GJITHSEJ 14

NUMRI I PUNONJËSVE GJITHSEJ NË ZYRËN VENDORE ARSIMORE DO TË JETË 14 VETA.



URDHËR
NR. 264, datë 19.4.2019

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENIN E ULZËS DHE SHKOPETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo mjeti dhe metode gjuetie si dhe, mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve të familjes së krapit në liqenin e Ulzës dhe të Shkopetit dhe konkretisht:

a) për liqenin e Ulzës, për periudhën 20.4.2019 deri më 31.5.2019.

b) për liqenin e Shkopetit, për periudhën 20.4.2019 deri më 30.6.2019.

2. Ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 150 ml nga bregu (për liqenin e Ulzës) dhe 100 metra (për liqenin e Shkopetit) dhe konkretisht:

a) për liqenin e Ulzës, për periudhën 1.6.2019 deri më 30.6.2019.

b) për liqenin e Shkopetit, për periudhën 1.7.2019 deri më 31.7.2019.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në, e cila ushtron aktivitetet peshkimi në këto dy liqene.

5. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës Sektori i Inspektimit e Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Ulzës dhe Shkopetit, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore

të Bashkisë së Matit, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në Qarkun e Dibrës, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit të Qarkut Dibrë, si dhe me Njësinë Gjeneruese të H/C-ve Ulzë e Shkopet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

URDHËR
NR. 265, datë 19.4.2019

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENIN E OHRIT DHE PRESPËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve të familjes së krapit në liqenin e Ohrit dhe të Prespës dhe konkretisht:

a) për liqenin e Ohrit, për periudhën 20.4.2019 deri më 1.7.2019.

b) për liqenin e Prespës, për periudhën 25.4.2019 deri më 25.5.2019.

2. Ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 300 ml nga bregu (për liqenin e Ohrit) dhe 150 metra (për liqenin e Prespës) dhe konkretisht:

a) për liqenin e Ohrit, për periudhën 1.7.2019 deri më 31.7.2019.

b) për liqenin e Prespës, për periudhën 25.5.2019 deri më 25.6.2019.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe



Akuakulturës në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitetet peshkimi në këto dy liqene.

5. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës është Sektori i Inspektimit e Kontrollit të Peshkimit, Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Ohrit e Prespës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore të Pogradecit e Korçës, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në Qarkun e Korçës dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit të Qarkut Korçë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 244, datë 19.4.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 11, pikave 2 dhe 3, të

ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 23.4.2019 deri në datën 3.5.2019.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë